



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT
DHE AFTËSIVE 2023-2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT
PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj si dhe Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Vendim Nr. 659, datë 10.10.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA